

## RELACION

### Mbi

### Raportet e monitorimit per vitin 2022

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, Gjykata e Lartë ka bërë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore duke zbatuar me përpikmeri legjislacionin në fuqi.

Fondi i vënë në dispozicion të Gjykatës së Lartë për këtë periudhë është në shumën 280,711 mijë leke. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi fond të celur në art. 606 “ transferata për buxh familjar dhe individe ” shumën 1,944.8 mijë lekë,.

Buxheti i realizuar është 269,450 mijë lekë, i detajuar si më poshtë:

Në 000 lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti Viti 2022. Në fillim	Buxheti Viti 2022. i rishikuar	Realizimi Viti 2022
230	PROJEKT	10	0	0
231	INVESTIME GJITHESEJ	58,050	37,678	30577
600	PAGA	200,000	181,200	180,073
601	KONTR.SIG. SHOQERORE	25,000	21,633	21,632
602	MALLRA DHE SHERB.TJERA	18,400	40,200	35,239.00
606	TRANSFERIME PER BUXHET FAM & IND		1945	1929
		<b>301,460</b>	<b>282,656</b>	<b>269,450</b>

#### **ANEKSI nr.1” Raporti I shpenzimeve sipas Programeve” .**

#### **ANEKSI nr.2 ”Raporti I Shpenzimeve te Programit sipas Artikujve Buxhetore”.**

Në të dyja këto anekse shohim se gjatë këtij viti kemi mosrealizim në shumën 13,206 mijë lekë me planin e rishikuar.

Sipas artikujve kemi mosrealizim në art.600 diferenca është në shumën 1,127 mijë lekë dhe art.601 diferenca është 1 mijë lekë.Kjo për arsye të rishikimit të fondit vjetor , të mos plotësimit të numrit të punonjesve të planifikuar në organikë.

Në art .602 kemi një mosrealizim prej 4,961 mijë lekë.

Në zërin Shpenzime per mallra e sherbime, gjate viti 2022 janë planifikuar dhe realizuar me procedurë prokurimi ”Blerje me vlerë të vogël” në menyre elektronike si dhe me procedure “me vlerë nën 100 mijë lekë”: larje makinash, mirembajtje ashensori, hostim i faqes web të Gjykatës

së Lartë, siguracioni i mjeteve të transportit, mirembajtje të paisjeve elektrike e teknike, ( kondicionerë, gjeneratorë), mirëmbajtje mjete transporti , botime, mirëmbajtje sistem sigurie, mirëmbajtje sistem kundra zjarrit, blerje goma automjetesh , shërbim printimi , shtypshkrime, blerje uniforma, etj, për të cilat janë lidhur kontratat respektive me afat deri 31.12.2022.

Përsa i perket realizimit të shpenzimeve në zërat e mësipërm, janë realizuar shpenzimet për kancelari në shumën 571 mijë, botime 317 mijë, material pastrim disinfektim në shumën 532 mijë, shtypshkrime 300 mijë, karburant në shumën 3,086 mijë , goma makine 201 mijë, larje makine 562 mijë, siguracion automjetesh 448 mijë, pjesë këmbimi 2,491 mijë, mirëmbajtje ashensori 182 mijë, mirëmbajtje elektrike hidraulike 180,4 mijë, mirëmbajtje godine 100 mijë , mirëmbajtje lulishte 69 mijë, mirëmbajtje kondicioneri 41 mijë, mirëmbajtje sistem sigurie 548 mijë, mirëmbajtje sistem kundra zjarrit 119 mijë, mirëmbajtje faqe web 335 mijë, etj.

Shpenzimet për shërbime: energji elektrike, uje telefon, poste etj janë realizuar sipas planifikimit buxhetor.

Gjithashtu janë realizuar shpenzime për: pritje, udhetim e dieta, kuotizacion etj si me poshtë :

Shpenzime kuotizacioni 439 mijë lekë , dieta e udhëtime jashtë vendit në shumën 2,051 mijë lekë dhe dieta administrative 5 mijë.

Për këtë vit janë zhvilluar tenderat me procedurë “marreveshje kuader” për një afat 4 vjecar si më poshte:

1-Mirëmbajtje mjete transporti shoqëria e shpallur fituese është firma “ Servis Auto 2000”sha

2-Shërbim printimi, shoqeria e shpallur fituese është firma “Infosoft Office”sha dhe është në fazën e ekzekutimit të kontratës

3- Blerje karburanti , shoqëria fituese është Gegas Oil dhe është në fazën e ekzekutimit të kontratës.

Në art 606 në këtë periudhe kemi celje fondi në “transfera tek individet” në shumën 1,945 mijë lekë..

Ne artikullin 231 “ kapitale të trupëzuara janë planifikuar :

5,250 mije lekë për Blerje Pajisje e ndarë kjo në “Blerje pajisje mobilje” në shumën 4,470 mijë lekë dhe “Blerje kondicionerë” në vlerën 790 mijë lekë.

Për blerje pajisje elektronike janë planifikuar 8,476 mijë lekë.

Është realizuar procedura e prokurimit me “Blerje me vlerë të vogël” per blerjen e kondicinereve, është lidhur kontrata me firmën fituese ” A2N Termoklima “ në vlerën 786 mijë lekë, është bërë likuidimi i saj.

Për fondin 5,250 mijë lekë planifikuar për blerje mobilje është realizuar procedura elektronikisht, me tender, është shpallur fitues firma Dromeas Albania shpk në vleren 4,194 mijë lekë , është bërë realizimi i kontratës dhe likuidimi i saj .

Ne lidhje me pjesën tjetër të fondit në shumën 8,500 mijë lekë për blerje “ Pajisje Elektronike” është realizuar procedura elektronikisht për blerje program software në shumën 1,700 lekë, , është shpallur fitues firma Togo shpk në vlerën 1,676 mijë lekë , është realizuar kontrata dhe është bërë likuidimi i saj.Për pjesën tjetër të fondit për blerje pajisje elektronike mund të themi se fondi është prokuruar dy herë dhe procedura është anuluar nga KPP,Kështu që fondit nuk u përdor.

Gjithashtu është realizuar procedura elektronikisht me tender për rikonstruksion godine me fond 25,000 mijë lekë, është shpallur fitues firma O.B KONKSTRUKSION në vlerën 23,090 mijë , është realizuar kontrata dhe është bërë likuidimi i saj.Nje pjesë e fondit të rikonstruksionit është përdorur për likuidimin e kontratës së lidhur për mbikqyrjen e punimeve të rikonstruksionit në shumën 590 mijë lekë.

Për artikullin 602 kemi mosrealizim në shumën 4961 mijë .Mosrealizimi konsiston më shumë në zërat e planifikuar për shpenzime për avokat kryesisht, shpenzime për përkthyes, për ekspert, pritje përcjellje, ekzekutim vendime gjyqësore etj.

### **ANEKSI Nr.3 ‘Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit**

Ne lidhje me produktin A ”Ceshtje te Gjykuara” shohim se kemi nje ulje te koston krahasuar me vitin 2021, kjo si rezultat i plotesimit te organikes me gjyqtare dhe keshilltarë ligjor.

Në produktin E” Rikonstruksion godine”, për vitin 2022 u planifikuan 25,000 mijë lekë fonde, u prokuruan dhe është realizuar dhe likuiduar kontrata në Shumën 23,680 mijë lekë.

Ne produktin F “ Mobilje” kemi planifikuar 5250 mijë leke per vitin 2022 dhe eshte lidhur kontrata ne vleren 4,194 mijë leke per blerje Pajisje mobilje dhe eshte realizuar dhe likuiduar kontrata per blerje kondicionere ne shumën 786 mijë leke, blerje perde dhe blerje aparat për thithjen e lageshtisë me procedure me “blerje nën 100 mijë lekë” ne vlerën 120 mijë lekë secila.

Ne Produktin K “ Pajisje elektronike per gjykatën” jane planifikuar 8,500 mijë leke , eshte realizuar dhe likuiduar vetëm kontrata e procedures për blerje programi software ne vleren 1676 mijë lekë,Procedura, për blerje pajisje elektronike nuk u përfundua pasi u pezullua dhe u anulua nga KPP-ja.

### **ANEKSI 4. Produktet e investimeve me financim te brendshem**

Ne aneks shohim se eshte planifikuar fondi per gjithe vitin 2022 39,050 mijë lekë.

Me kod projekti M290068 “RIKONSTRUKSION” ne Shumën 25,000 mijë leke eshte realizuar deri në 15 Shtator 2022

Me kod projekti 18 AD801 “Mobilje –Pajisje” ne Shumen 5,550 mije leke eshte realizuar deri ne Dhjetor 2022.

Me kod projekti M290072 “Blerje pajisje elektronike” ne Shumen 6,800 nuk u realizua procedura.

Me kod projekti 21AC501 “Blerje program software” eshte parashikuar prej 1,700 mije leke eshte lidhur kontrata me fond 1,676 mije leke dhe eshte realizuar deri ne Dhjetor 2022.